

VENDIM
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga:

Fehmi Abdiu, Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci, Anëtar i Gjykatës Kushtetuese
Hajredin Fuga, Anëtar i ““
Alfred Karamuço, Anëtar i ““
Bardha Selenica, Anëtare e ““
Kristofor Peçi, Anëtar i ““
Kujtim Puto, Anëtar i ““
Sokol Sadushi, Anëtar i ““

Me sekretare Drita Filto, më datë 25.01.2000, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura kërkesën me nr. 8, Akti që i përket:

KËRKUES: HILMI DAKLI

OBJEKTI: Deklarimi i mbarimit të mandatit të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese.

BAZA LIGJORE: Neni 128 pika 2 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

Pasi administroi kërkesën për dorëheqje të zotit Hilmi Dakli, anëtar i Gjykatës Kushtetuese,

V Ë R E N

Zoti Hilmi Dakli, anëtar i Gjykatës Kushtetuese në datën 24.01.2000, ka deklaruar se jep dorëheqjen nga detyra që kryen.

Gjykata Kushtetuese, konstatoi faktin e dorëheqjes së tij dhe e gjeti atë të bazuar në nenin 127 pika “ç” e Kushtetutës.

Duke qenë kështu, ajo çmon se konform pikës 2 të këtij neni, duhet deklaruar mbarimi i këtij mandati.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 127 pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 41 të Ligjit nr. 8373, datë 15.07.1998 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

V E N D O S I:

Të deklarojë mbarimin e mandatit të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, zotit Hilmi Dakli.
Ky vendim është përfundimtar dhe i formës së prerë.

Tiranë më 25.01.2000
Nr. 8 i regjistrimit themeltar
Nr. 2 i Vendimit